



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2023:305048

Datë: 15.05.2024

Numri i dokumentit: 05737038

P.nr.361/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEGA ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Petrit Nrecaj, në çështjen penale kundër të pandehurit S.E, për shkak të veprës penale kanosja nga neni 181 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.2345/23 e datës 27.12.2023, në bazë të nenit 248 par.1 nën par. 1.4 të Kodit nr.08/L-032 të Procedurës Penale (tutje KPP), dhe neneve 14, 15, 17 të Ligjit nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, jashtë seancë me datë **15.05.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET** marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit me numër të lëndës në ndërmjetësim **ND.nr.37/24 e datës 14.03.2024**, në mes të pandehurit S.E, në njërën anë dhe palës së dëmtuar M.M, në anën tjetër.
- II. HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.2345/23 e datës 27.12.2023 dhe **PUSHOHET** procedura penale, kundër të pandehurit **S.E**, i lindur me datë ... në Bijelo Polje, Crna Gora, me venbanim në rr."28 Nëndori" fshati B. Komuna I., me nr. Personal ... shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i akuzuar për shkak të veprës penale kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-së.
 - ***Për shkak se i pandehuri dhe i dëmtuari kanë lidhë marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit sipas Ligjit për Ndërmjetësim, e cila marrëveshje është aprovuar zyrtarisht nga gjykata.***

III. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, në këtë gjykatë ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.2345/23 e datës 27.12.2023 kundër të pandehurit Sh.E, për shkak te veprës kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-së.

Gjykata pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, duke u bazuar në dispozitat e nenit 2, 4, 8 dhe 12 të Ligjit për Ndërmjetësim dhe nenin 229 par.1 dhe 2 të KPP-së, me Vendimin e **datës 14.03.2024** këtë çështje penale e ka referuar në ndërmjetësim në Qendrën e Ndërmjetësimit në Gjykatën Themelore në Pejë – Dega Istog.

Gjykata **me datë 14.03.2024**, nga Qendra e Ndërmjetësimit në Gjykatën Themelore në Pejë – Dega Istog, është njoftuar me:

- **Modelin e Marrëveshjes për Ndërmjetësim** (Shtojcën 2), sipas të cilës rezulton se palët e lartcekura si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktvendimi, janë pajtuar për ta zgjidhur kontestin e tyre në procedurën e ndërmjetësimit, dhe
- **Modelin e Marrëveshjes për Zgjidhjen e Ndërmjetësuar** (Shtojcën 3), sipas të cilës rezulton se ndërmjet palëve të lartcekura si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktvendimi është arritur marrëveshja në procedurën e ndërmjetësimit. E cila marrëveshje pasi që është nënshkruar nga ndërmjetësuesi, është proceduar në gjykatë te gjyqtari i çështjes për aprovim.

Gjykata me vendimin e **datës 18.03.2024** (shtojcën 5), e ka aprovuar marrëveshjen e arritur ne procedurën e ndërmjetësimit ndërmjet palëve si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktvendimi, konform nenit 15 te Ligjit për Ndërmjetësim, e cila marrëveshje është dokument i ekzekutueshëm.

Sipas nenit 248 par. 1, nën par. 1.4 të KPP-së, përcaktohet se Gjykata e hedhë aktakuzën dhe e pushon procedurën kur: *“ i pandehuri dhe i dëmtuari kanë lidhur marrëveshje ndërmjetësimi që është pranuar zyrtarisht nga gjykata ”*.

Gjykata pasi ka vërtetuar se në këtë çështje penale palët kanë arritur marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit, duke vlerësuar se marrëveshja e lidhur në procedurën e ndërmjetësimit ndërmjet palëve është e paraparë dhe në pajtim me Ligjin për Ndërmjetësim dhe dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, si dhe pas aprovimit të kësaj marrëveshje nga ana e Gjykatës, e duke vepruar konform nenit të sipërcituar 248 par. 1, nën par. 1.4 të KPP-së, u vendos që të hudhet aktakuza dhe të pushohet procedura penale ndaj të pandehurit si në pikën II, të diapozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata vendimin, lidhur me shpenzimet e kësaj procedure penale e ka marrë konform nenit 453 par.1 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë, në bazë të neni 248 par.1 nën par. 1.4 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA ISTOG
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal

GJYQTARI,
Petrit Nrecaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej tri (3) ditësh, nga dita e pranimit, ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate. *Në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.*